



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 2976 Prot.

Tiranë, më 2 . 6 .2025

Lënda: Vënie në dispozicion të listës së përditësuar të avokatëve dhe të dhënave të kontaktit

**Z. MAKSIM HAXHIA
KRYETAR I DHOMËS KOMBËTARE TE AVOKATISË**

TIRANË

I nderuar z. Haxhia,

Edhe disa herë të tjera Gjykata e Lartë ju është drejtuar me kërkesë për vënien në dispozicion të listës së përditësuar të avokatëve së bashku me të dhënat e kontaktit (telefon, email dhe adresë), por për fat të keq kërkesa jonë ka mbetur ende e paplotësuar.

Nisur nga numri i lartë i njoftimeve që bën Gjykata e Lartë në adresë të palëve ndërgjyqëse, në vlerësimin tonë njoftimi elektronik apo me telefon i avokatëve të palëve, do të lehtësonte ndjeshëm punën e sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Lartë në kryerjen e njoftimeve, si dhe nga ana tjetër, do t'i krijonte mundësinë palëve në marrjen dijeni të njoftimit në mënyrë më të shpejtë e më të sigurtë se sa përdorimi i metodave të tjera.

Ne jemi të detyruar që të insistojmë përsëri në kërkesën tonë për vënien në dispozicion të listës së përditësuar të avokatëve së bashku me të dhënat e kontaktit. Dëshiroj të theksoj se vënia në dispozicion e kësaj liste nga ana juaj është shumë e rëndësishme për veprimtarinë tonë, por që nga ana tjetër, shpreh bindjen e plotë se do të sillte avantazhe edhe për vetë avokatët.

Në këtë aspekt, bashkëpunimi reciprok për këtë çështje vlerësoj se do të jetë në dobi jo vetëm të Gjykatës së Lartë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, por edhe të përfituesve të shërbimeve gjyqësore, që janë palët ndërgjyqëse. Veç kësaj, vlerësojmë se është e rëndësishme edhe ndërmarrja e një fushate sensibilizuese nga ana e strukturave drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, për të orientuar në të ardhmen avokatët që në aktet e ndryshme procedurale që ata hartojnë dhe depozitojnë në gjykatë, të shënojnë detyrimisht dhe të dhënat personale të kontaktit.

Gjithashtu, do të vlerësonim angazhimin tuaj që kjo listë të na vihej në dispozicion në një kohë të shpejtë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
SOKOL SADISHI

